



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës
Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

Nr. _____

Datë: 05.10.2017

Duke u bazuar në nenin 10 dhe 119, par. 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në mbështetje të LIGJIT Nr. 03/L-229 PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS neni 28, neni 29, 32, 34, 35, 38, dhe në mbështetje të LIGJIT Nr. 04/L-226 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT Nr. 03/L-229 PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS neni 2 paragrafi 2 pika 1.7, në mbështetje të LIGJIT Nr. 05/L-031 PËR PROCEDURËN E PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE, në mbështetje të STATUTIT të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës Nr. 04-V-312 të datës 02.03.2012, dhe neni 8 paragrafi 1.6, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës në Mbledhjen e mbajtur më 05.10.2017 ka:

Konstatuar se:

- Autoriteti Kosovar e Konkurrencës në bazë të analizës ligjore dhe analizimin e rastit, vlerëson se institucioni kompetent për zgjidhjen e ankesës së ndërmarrjes Railtrans sh.p.k. kundër NP Trainkos sh.a. Për ofrimin e shërbimeve, servisimin, tërheqjen e lokomotivave, dhe ofrimin e çmimoreve për shërbimet e tyre, është Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave, në bazë të Ligjit Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës.
- Autoriteti Kosovar i Konkurrencës vlerëson se nëse institucionet të cilat kanë kompetenca ligjore për rregullimin e tregut të caktuar siç është në këtë rast Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave, do të duhej të zgjidhë çështjen në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës dhe rekomandimit të saj i datës 24.11.2016 dhe përkitazi me këtë rast Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës nxjerr këtë:

REKOMANDIM
PËR

Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave (ARH) që të:

- I. Bëjë vlerësimin dhe verifikimin e pretendimeve të NP Trainkos sh.a. nëse kanë kapacitete teknike e teknologjike, hapësirë të mjaftueshme (hangarë), kapacitete humane, për të ofruar këto shërbime për kompanin Railtrans sh.p.k.
- II. Nëse NP Trainkos sh.a. ka kapacitete të mjaftueshme për ofrimin e këtyre shërbimeve, ARH të shfrytëzojë mundësit ligjore që ta obligojë NP Trainkos sh.a. të futet në marrëveshje me ndërmarrjen Railtrans sh.p.k. për ofrimin e shërbimeve që i ka për obligim me i ofruar për ndërmarrës tjerë në tregun përkatës sipas Ligjit për Hekurudhat e Kosovës Nr. 04/L-063.
- III. Nëse ARH vlerëson se NP Trainkos sh.a. nuk ka kapacitete teknike, teknologjike dhe humane për t'i ofruar këto shërbime atëherë të shfrytëzojë mundësit ligjore për sigurimin e kushteve për hapjen e tregut hekurudhor për kompani të reja që do të ofrojnë këto shërbime në mënyrë që tregu hekurudhor të jetë i liberalizuar, konkurrues e jo diskriminues.
- IV. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës rekomandon Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave që të marrë masa të zgjidhë çështjen kontestuese në tregun përkatës, ndërmjet Railtrans sh.p.k & NP Trainkos sh.a. në të kundërtën Autoriteti Kosovar i Konkurrencës do të veproj bazuar në dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës sepse do të ketë rrezik për dëmtim të pariparueshëm për konkurrencën e tregut, sidomos në rastet kur veprimet e caktuara çrregullojnë konkurrencën.

A r s y e t i m

Me datën 10.11.2016 Autoriteti ka pranuar një shkresë (e ripërtërirë me 24.04.2017) nga kompania Railtrans sh.p.k. me pretendimin se NP Trainkos sh.a. është duke abuzuar me pozitën dominuese në tregun përkatës për arsye se:

1. Ankuesi ka kërkuar nga NP Trainkos sh.a. të ofrojë çmimoren për qasjen në punëtorin e tyre për marrjen e shërbimeve për mirëmbajtjen e lokomotivave, për arsye se në Kosovë asnjë ndërmarrje tjetër nuk ofron shërbime e punëtori të tillë.
2. Deklarimi i ndërmarrjes Railtrans sh.p.k. ka për qëllim t'i servisojë lokomotivën në punëtorin e NP Trainkos sh.a. dhe është duke pritur një përgjigje për ofrimin e këtij shërbimi mirëpo nuk kanë marrë përgjigje e as shërbimet e kërkuara deri më tani.
3. Sipas ankuesit, NP Trainkos sh.a. është e obliguar të ofrojë këto shërbime sipas Ligjit Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës.

Autoriteti Kosovar e Konkurrencës gjatë monitorimit të tregut përkatës lidhur me rastin, takimeve të zhvilluara me palët të cilët janë të ndërlidhura me çështjen, analizimit dhe vlerësimin të të dhënave të grumbullara nga ARH, NP Trainkos sh.a., ndërmarrja Railtrans sh.p.k. dhe konsultimit me rregullativën ligjore konkludojm se:

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës në bazë të analizës ligjore vlerëson se institucioni kompetent për zgjidhjen e këtij rasti është organi mbikëqyrës i NP Trainkos sh.a & NP Infrakos sh.a. brenda hapsirës së veprimit që ofron Ligji për Hekurudhat e Kosovës Nr. 04/L-063. Me dispozitat e këtij ligji rregullohet kjo çështje pa qenë e nevojshme që të fillohet me procedurat hetimore nga Autoriteti i Konkurrencës për të vërtetuar pretendimet e palës ankuese për abuzim me pozitën dominuese të NP Trainkos sh.a. në tregun relevant.

Sipas ligjit për Hekurudhat e Kosovës Nr.04/L-063, *neni 25, paragrafi 1 thot*: Organi Rregullativ i Tregut Hekurudhor e ka për detyrë që të bëjë sigurimin e kushteve për hapjen e tregut hekurudhor në Kosovë, *paragrafi 3. Detyrat e Organit Rregullativ të Tregut Hekurudhor janë si në vazhdim, nën paragrafi 3.2.* sigurimi që qasja në binarë, qasja në stacione, qasja në depot e operatorëve që plotësojnë kushtet e domosdoshme të jetë e drejt, transparente dhe jo diskriminuese.

Sipas Ligjit për Hekurudhat e Kosovës Nr.04/L-063, *neni 51, paragrafi 1. dhe nënparagrafi 1.1.* binarë hekurudhorë, leje për shfrytëzimin e atij binari për transportin e udhëtarëve dhe të mallrave, operimin dhe tërheqjen e trenave vetëm në atë binar në mënyrë që të arrihet deri te konsumatori fundor apo për të arritur qasje tek pajisjet speciale hekurudhore te konsumatori final pasi që kjo mund të arrihet vetëm nëpërmes të qasjes së ofruesit të pajisjeve speciale. *Paragrafi 2.* Në rastin kur aplikuesi nuk ka sukses në arritjen e marrëveshjes për qasje me ofruesin e pajisjeve speciale hekurudhore, atëherë ai mund të kërkoj intervenimin e Organit Rregullativ të Tregut. *Paragrafi 3.* Në bazë të ankesës nga aplikuesi apo me vetiniciativë, Organi Rregullativ i Tregut mund të vendos që ofruesi i pajisjeve speciale hekurudhore të futet në kontratën e qasjes me aplikuesin, për qëllim apo në lidhje me shfrytëzimin e pajisjeve speciale hekurudhore të specifikuar. Kjo e gjitha mund të bëhet pasi që të jetë bërë ekzaminimi i plotë nëse dhe deri në cilën masë ekziston: *Nënparagrafi 3.3.* abuzimi eksploatues për shkak të sjelljes monopoliste; *Nënparagrafi 3.4.* përjashtimi i aplikantëve të tjerë, konkurruesve apo sjelljes kundër konkurruese; *Nënparagrafi 3.5* sjelljeve tjera diskriminuese. *Paragrafi 4. Nëse ofruesi i pajisjeve shërbyese speciale hekurudhore nuk zbaton vendimin, Organi Rregullativ i Tregut ka të drejtë të shfrytëzojë mundësitë ligjore për detyrimin e tij.*

Ligji për Hekurudhat e Kosovës neni 51, paragrafi 3 me nën paragrafët 3.3, 3.4, dhe 3.5 qartazi e obligojnë Organin Rregullativ i Tregut – ARH-në që të mos lejojë abuzime eksploatuese me sjellje monopoliste, të mos përjashtojë aplikantë tjerë nga tregu me sjelljet jo konkurruese si dhe sjellje tjera jo diskriminuese në tregun përkatës.

Sipas Ligjit për Hekurudhat e Kosovës Nr. 04/L-063 me dispozitat e tij përkatëse të theksuara më lartë duket qartazi se pala me pretendimet e tij ka mundur të bëjë zgjidhje në

institucionin kompetent për këtë çështje. Duke u bazuar në dispozitat e theksuara më lartë të Ligjit për Hekurudhat e Kosovës Nr. 04/L-063, sipas interpretimit të Autoriteti të Konkurrencës kompetente për zgjidhjen e këtij rasti është Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave të Kosovës pasi që është organ mbikëqyrës i NP Trainkos sh.a. dhe NP Infrakos sh.a.

Konsiderojmë se nëse ARH zbaton këto dispozita dhe e obligon NP Trainkos sh.a. për tu futur në marrëveshje për ofrimin e shërbimeve të tyre ndërmarrësve tjerë siç është e obliguar me ligj atëherë Autoriteti i Konkurrencës nuk mund të ndërhyj përderisa ka hapsirë, kompetenc dhe bazë ligjore me Ligjin mbi Hekurudhat e Kosovës që ARH të ndërmarrë veprime ligjore për zgjidhjen e kësaj çështje. Në rekomandimin e ARH-së i datës 24.11.2016 i është rekomanduar NP Trainkos sh.a. që të lidh marrëveshje me ndërmarrjen Railtrans Sh.p.k. për qasjen në shërbimet hekurudhore që ndërlidhen me shfrytëzimin e pajisjeve speciale hekurudhore të paraqitura në kërkesën e ankuesit.

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave si organ mbikëqyrës i tregut hekurudhor në Kosovë inkurajohet që të shfrytëzojë mundësit ligjore për të hapur tregun për ndërmarrjet të reja hekurudhore me qëllim që tregu të gjeneroj zhvillim ekonomik. Me një treg të hapur dhe konkurrues do të ketë shërbime e çmime më të mira për konsumatorin e me këtë rast do të eliminoheshin sjelljet abuzive monopliste në tregun relevant.

**KOMISIONI
AUTORITETI KOSOVAR I KONKURRENCËS**

(_____
Valon Prestreshi
Kryetar

(_____
Ahmet Krasniqi
Zv. Kryetar

(_____
Fatime Haziri
Anëtare

(_____
Muhamed Krasniqi
Anëtar

(_____
Shaqir Morina
Anëtar

Me këtë Rekomandim të njoftohen:

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
Railtrans sh.p.k.
Arhiva